

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2024

Lënda: HISTORI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Në cilën nga periudhat e mëposhtme u formua vetëdija e përbashkët kulturore dhe etnike e fiseve ilire?

1 pikë

- A) Në periudhën e Neolitit
- B) Në periudhën e Eneolitit
- C) Në periudhën e Bronzit
- D) Në periudhën e Hekurit

2. Lufta midis Spartës dhe Athinës njihet në histori me emrin:

1 pikë

- A) Lufta Perse
- B) Lufta e Peloponezit
- C) Lufta e Mikenës
- D) Lufta e Athinës

3. Cili prej pohimeve është një ndër dy kërkesat kryesore të plebejve drejtuar Senatit në Romë?

1 pikë

- A) Përmirësimin e kushteve të jetesës në qytete.
- B) Pjesëmarrje më të gjerë të plebejve në jetën politike.
- C) Krijimin e një Perandorie të madhe Romake.
- D) Një ndarje të re të shoqërisë romake.

4. *"Asnjë njeri i lirë nuk do të burgoset, ... ose dëmtohet në ndonjë mënyrë, ... përveçse nga një gjykim i ligjshëm nga njerëzit e tjerë, ose nga ligji i vendit... Asnjërit nuk do t'i shitet, mohohet apo vonohet e drejta dhe drejtësia"*
Magna Carta 1215 (e përshtatur)

Sipas deklaratës së mësipërme, cila e drejtë kushtetuese është më e lidhur me Kartën e Madhe të Lirive (Magna Carta)?

1 pikë

- A) E drejta e të akuzuarit për të kërkuar liri pa gjykim
- B) E drejtat e sklevërve për të votuar
- C) E drejta e të akuzuarit për një proces të drejtë
- D) E drejta e qytetarëve për të mbajtur armë

5. Harta e mëposhtme tregon një nga rrugët e zbulimeve të mëdha gjeografike. Rrugën e pasqyruar në hartë e ndoqi:

1 pikë

- A) Bartolomeo Dias
- B) Amerigo Vespuçi
- C) Kristofor Kolombi
- D) Fernando Magelani



6. Uniteti fetar në Evropë u dobësua gjatë periudhës së:

1 pikë

- A) kryqëzatave
- B) reformacionit
- C) zbulimeve të mëdha gjeografike
- D) shkatërrimit të perandorisë Inkase

-
7. Katerina e Madhe njihet si një nga monarkët e iluminuar, e cila me reformat e ndërmarra u përpoq për modernizimin dhe evropianizimin e Ruisë. Pavarësisht arritjeve ajo **NUK** mori asnjë masë për: **1 pikë**
- A) artin.
B) arsimin.
C) shkencën.
D) bujkrobërinë.
8. Një nga vendimet e Kongresit të Vjenës ishte: **1 pikë**
- A) Vendosja e parimit të Legjitimitetit
B) Krijimi i kufijve të rinj në Afrikë
C) Dhënia fund e abuzimeve nga kisha katolike
D) Mbrojtja e Evropës nga pushtimi Otoman
9. Sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës, Shqipëria: **1 pikë**
- A) vendosej nën protektoratin italian.
B) eliminohej tërësisht si entitet shtetëror.
C) fitonte territore në dëm të Perandorisë Osmane.
D) formohej si shtet duke bashkuar katër vilajetet shqiptare.
10. Programi prej 14 pikash i presidentit Uilson ishte një plan pune për: **1 pikë**
- A) Vendosjen dhe ruajtjen e paqes afatgjatë në botë
B) Përcaktimin e dëmshpërblimeve të luftës
C) Zgjerimin e perandorive koloniale
D) Zbatimi i Planit Marshall
11. Ai riktheu demokratët në Shtëpinë e Bardhë, me një sukses të rëndësishëm duke u mbështetur mbi platformën e liberalizmit modern "Kursi i Kufirit të Ri": **1 pikë**
- A) Ajzenhauer
B) Regan
C) Klinton
D) Kenedi
12. Gjatë qëndrimit të tij në krye të vendit, ai u përpoq të rigjallëronte regjimin komunist përmes forcimit të rolit të parlamentit, dobësimit të rolit të partisë, lirisë së fjalës etj. Këto reforma u ndërmorën nga udhëheqësi komunist: **1 pikë**
- A) Brezhnjev
B) Gorbaçov
C) Gomulka
D) Dubček
13. "Prej Baltikut në Adriatik, një vijë ndarëse është krijuar qartë. Një "Perde e Hekurt", ka rënë në Evropë". Në këtë pasazh, Çerçilli i është referuar: **1 pikë**
- A) vendosjes së komunizmit
B) vendosjes së nazizmit
C) Luftës së Ftohtë
D) Luftës në Kore

-
14. Cili prej fiseve të mëposhtme e mori pas Enkelejdhëve stafetën në drejtimin e shtetit ilir? 1 pikë
- A) Molosët
B) Dardanët
C) Taulantët
D) Ardianët
15. Kryeqendra e principatës së Arbrit ishte: 1 pikë
- A) Durrësi
B) Lezha
C) Kruja
D) Dibra
16. Shteti i Skënderbeut ishte i organizuar në formën e: 1 pikë
- A) Republikës parlamentare
B) Republikës feudale
C) Monarkisë parlamentare
D) Monarkisë feudale
17. Partneri kryesor në politikën e jashtme gjatë qeverisjes së Zogut ishte: 1 pikë
- A) Greqia
B) Anglia
C) Italia
D) Jugosllavia
18. Vendosja e regjimit monarkik pas lufte dhe rikthimi i mbretit Zogu I, ishte pjesë përbërëse e programit politik të: 1 pikë
- A) Ballit Kombëtar
B) Lëvizjes së Legalitetit
C) Partisë Komuniste
D) Frontit ANÇ
19. Rendi në rend kronologjik shkëputjen e marrëdhënieve diplomatike/ekonomike të Shqipërisë me vendet e mëposhtme. 1 pikë
- A) Jugosllavi, BS, Kinë
B) BS, Kinë, Jugosllavi
C) Kinë, Jugosllavi, BS
D) Jugosllavi, Kinë, BS
20. Ndalimi me ligj i fesë në Shqipëri, u vendos në kushtetutën e vitit: 1 pikë
- A) 1914
B) 1922
C) 1946
D) 1976

21. Athina ishte djepi i lindjes së demokracisë në antikitet. Përfaqësuesi kryesor i demokracisë në Athinë ishte Perikliu.

a) Krahasoni demokracinë athinase para qeverisjes së Perikliut dhe gjatë qeverisjes së tij. Nxirrni të paktën një ndryshim midis tyre. 1 pikë

b) Pavarësisht arritjeve të Perikliut lidhur me demokracinë, ajo prapë ishte e kufizuar. Jepni dy argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj. 2 pikë

22. Reformacioni i kishës katolike shënon një moment kulmor në historinë evropiane. Zbatimi në praktikë i tezave të Luturit pati rrjedhoja shumëdimensionale si në kuadrin e ngushtë fetar dhe kishtar, ashtu edhe në atë politik.

Jepni dy detyrat që shtroi Luteri për përhapjen e tezave të tij. 2 pikë

23. "Kur në këtë ose atë organ qeveritar pushteti legjislativ bashkohet me pushtetin ekzekutiv, kur nuk ekziston liria, ka rrezik që vetë monarku ose parlamenti të nxjerrë ligje tiranike dhe njëkohësisht t'i verë në zbatim. Liria nuk ekziston dhe atëherë, kur pushteti gjyqësor nuk është i ndarë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv..."

a) Identifikoni cili prej iluministëve është shprehur në këtë mënyrë. 1 pikë

b) Shpjegoni pikëpamjet e tij lidhur me paragrafin e mësipërm. 2 pikë

24. Rilindja Shqiptare ishte përcaktuese për formimin e ndërgjegjes kombëtare dhe ecurinë e lëvizjes patriotike deri në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Cilat ishin tri nga kërkesat që përmbante platforma e Rilindjes Kombëtare Shqiptare? 3 pikë

25. Më poshtë jepen pjesë nga fjalimet e dy personaliteteve që kanë kontribuar në krijimin e Italisë së bashkuar.

“Unë nuk ofroj as pagesë, as strehim, as ushqim; Unë ofroj vetëm uri, etje, marshime të detyruara, beteja dhe vdekje. Kush e do atdheun me zemër dhe jo vetëm me buzët e tij, të më ndjekë”.

Giuseppe Garibaldi

“Një vend nuk është një territor i thjeshtë; territori i caktuar është vetëm themeli i tij. Vendi është ideja që ngrihet mbi atë themel; është ndjenja e dashurisë, e ndjenja e miqësisë që lidh së bashku të gjithë bijtë e atij territori.”

Giuseppe Mazzini

a) Shpjegoni dy rrugët që u ndoqën për bashkimin e Italisë. **2 pikë**


b) Identifikoni një figurë tjetër që mori pjesë aktivisht në procesin e bashkimit të Italisë. **1 pikë**

26. Arsimi shqiptar ka kaluar nëpër një rrugë të gjatë me vështirësi e sakrificë të panumërta. Një plejadë e tërë patriotësh të ndritur u bënë nismëtarët e hapave përpara në fushën arsimore ku, padyshim, përcaktimi i alfabetit të gjuhës shqipe mbetet një gur themeli në arsimin dhe kulturën shqiptare.

a) Ku u mbledh Kongresi Kombëtar, për të zgjidhur çështjen e alfabetit? **1 pikë**

b) Çfarë vendimi u morr në këtë Kongres për çështjen e alfabetit? **1 pikë**

27. Shekulli XX u karakterizua nga tragjeditë e shkaktuara nga regjimet diktatoriale, të cilat sidomos në Evropë, patën pasoja shumë të rënda njerëzore dhe materiale si dhe një ndikim afatgjatë. Krahasoni totalitarizmin në Rusi me atë në Gjermani dhe plotësoni Diagramin e Venit duke dhënë dy tipare dalluese dhe një veçori të përbashkët midis tyre. **3 pikë**



Tiparet dalluese	Veçoria e përbashkët	Tiparet dalluese
1.	1.	1.
2.		2.

28. "Unë i gjuajta Franc Ferdinandit dy herë nga një distancë prej 4.5 hapash. Ktheva dorën për të bërë vetëvrasje, por disa policë dhe oficerë më kapën. Ata më morën me vete, për në stacionin e policisë. Unë nuk jam kriminel, por hoqa qafe një njeri të keq. Unë mendova se kjo ishte një gjë e drejtë"... .

Gavrilo Princip

Kjo vrasje shërbeu si shkëndijë për fillimin e një prej ngjarjeve më të rëndësishme të shek. XX. Identifikoni ngjarjen dhe evidentoni dy nga shkaqet e fillimit të saj. **3 pikë**

29. Më 21 janar 1925 Asambleja Kushtetuese shpalli Republikën Shqiptare dhe në mars të po atij viti u miratua Statuti Themeltar i Republikës ku Shqipëria përcaktohej si republikë parlamentare. Republika shqiptare edhe pse **de jure** ishte parlamentare, **de facto** kishte karakterin e një republike presidenciale. Presidenti kontrollonte të gjitha pushtetet. Shpjegoni si e realizonte ai këtë kontroll. **3 pikë**

30. Në gusht 1943 në takimin e mbajtur në Mukje morën pjesë përfaqësues të Frontit Nacional Çlirimtar dhe të Ballit Kombëtar.

a) Evidentoni një nga vendimet e marra me miratimin e përfaqësuesve të dy palëve në këtë takim. **1 pikë**

b) Shpjegoni dy arsye pse PKSH i hodhi poshtë pikat e kësaj marrëveshjeje. **2 pikë**

31. Franca është një nga demokracitë moderne më të konsoliduara. Ky konsolidim ka qenë rezultat i një procesi me shumë ulje – ngritje, i karakterizuar nga periudha destabiliteti të theksuar politik apo tronditje shoqërore (mbani parasysh ndërrimet e shpeshta të qeverive, efektet e krizës algjeriane apo lëvizjet studentore të 1968), por edhe nga një aftësi thelbësore për ndryshim dhe transformim, me ndikime të rëndësishme në jetën politiko-shoqërore të saj.

a) Identifikoni dy dallime në aspektin **konstitucional** mes Republikës IV dhe V franceze. **2 pikë**

Republika IV franceze	Republika V franceze
1.	1.
2.	2.

32.

Dokumenti nr. 1 Pjesë nga "Kushtetuta e vitit 1946"

Neni 5: ... Tregtia e jashtme është nën kontrollin e shtetit.

Neni 9: Garantohen pronësia private dhe iniciativa private në ekonomi. Garantohet e drejta e trashëgimit të pasurisë private.

Neni 10: Toka u takon atyre që e punojnë. Caktohet me ligj kur një institut ose një person që nuk e punon tokën mund të mbetet zot i kësaj toke dhe në ç'masë. Tokat e mëdha për asnjë arsye nuk mund të jenë në duart e privatëve.

Neni 16. Të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit. Kisha është e ndarë nga shteti. Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Ndalohet që Kisha dhe Feja të shpërdoren për qëllime politike. Gjithashtu ndalohen organizatat politike me bazë fetare. Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare.

Neni 18. Të gjithë shtetasve u garantohet liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e mbledhjes, e grumbullimit dhe e manifestimit publik.

Neni 19. Toka u jepet në përdorim shoqëror ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore, kooperativat bujqësore dhe organizatave shoqërore, si dhe në përdorim vetjak shtetasve. Toka jepet në përdorim pa shpërblim. Toka bujqësore mund të përdoret për qëllime të tjera vetëm me pëlqimin e organeve shtetërore përkatëse.

Dokumenti nr. 2 Pjesë nga "Kushtetuta e vitit 1976"

Neni 16: Ekonomia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është ekonomi socialiste, që mbështetet në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit. Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ka klasa shfrytëzuese, janë zhdukur dhe ndalohen prona private e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut.

Neni 27: Tregtia e jashtme është monopol i shtetit. Tregtia e brendshme ushtrohet kryesisht nga shteti, i cili ka nën kontroll çdo veprimtari në këtë fushë. Çmimet e shitjes së produkteve të ndërmarrjeve si edhe çmimet e blerjes së produkteve bujqësore e blegtorale nga shteti caktohen prej tij.

Neni 28: Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ndalohet dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe institucioneve të tjera ekonomike e financiare e të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe me shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, si edhe marrja e kredive prej tyre."

Neni 37: Shteti nuk njuh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.

a) Krahasoni Shqipërinë e vitit 1946 me atë të vitit 1976 në planin politik dhe atë ekonomik – shoqëror. **4 pikë**

b) A e përmirësoi ekonominë e shqiptarëve hyrja në fuqi e kësaj kushtetute? Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj. **1 pikë**

33. Një nga figurat më të njohura të iluminizmit evropian dhe jo vetëm, vendosi theksin tek misioni që ka çdo qeveri në mbrojtjen e lirive e të drejtave të qytetarëve. Nëse ajo nuk e realizon këtë mision dhe e shpall veten mbi ligjin, populli ka të drejtë ta rrëzojë atë.

Argumentoni shprehjen e iluministit Xh. Lok: "*Qeveria duhet t'i shërbejë shoqërisë*". A janë qeveritë që i shërbejnë shoqërisë apo shoqëria i shërben qeverisë. Jepni shembuj nga historia botërore. **5 pikë**
